



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:027758
Datë: 20.05.2024
Numri i dokumentit: 05709169

C.nr. 921/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Florian Krasniqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit: R.B, të cilin e përfaqëson avokat A.SH dhe avokat A.D., me adresë në, Prishtinë, kundër të paditurës “...” SH.A. me numër unik identifikues 81048581, me adresë në, Prishtinë, me objekt kontesti: pagesën e bonusit në pagë, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik, me datë 22.04.2024 mori dhe me datë 20.05.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit R.B, dhe **DETYROHET** e paditura “...” SH.A që paditësit në emër të bonusit vjetor prej 2.5% të fitimit neto, për periudhën 01.01.2016 deri me datë 30.04.2016 t’ia paguajë shumën prej 35,100 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, e cila do të llogaritet nga data 01.05.2017 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto brenda afatit ligjor prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.
- II. OBLIGOHET** e paditura që paditësit në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguajë shumën prej 1,487.2 euro, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm, ndërsa pjesa tjetër e kërkuar në emër të shpenzimeve të procedurës, në shumën prej 1,368.2 euro, refuzohet si e pabazuar.

A r s y e t i m

Padia dhe pretendimet e palëve

Paditësi, me datë 25 Shkurt 2020 pranë kësaj Gjykate ka paraqitur kundër të paditurës padi për pagesën e bonusit të paraparë me Kontratën e Punës të nënshkruarën me të paditurën. Në padi, ndër të tjera ka deklaruar se, fillimisht paditësi me të paditurën ka nënshkruar Kontratë të punës me datë 24 Mars 2014 e cila pastaj ishte vazhduar me Kontratën e Punës të datës 31 Mars 2015, dhe gjatë kësaj kohe paditësi i ka realizuar me sukses të lartë të gjitha përgjegjësitë dhe detyrat e punës të përcaktuara sipas kushteve dhe afateve të Kontratës. Tutje ka theksuar

se, me rastin e nënshkrimit të Kontratës së Punës, në nenin 7 të kësaj Kontrate ishte përcaktuar edhe e drejta në bonus të përformancës për paditësin, ashtu që lartësia e bonusit ishte përcaktuar në 2.5 % të neto fitimit të paditësit nga aktiviteti afarist/bankar. Më tej ka theksuar në padi se, lartësia e bonusit ishte paraparë që të përcaktohet në mbledhjen e përgjithshme kur do të bëhej aprovimi i pasqyrave financiare, ndërsa e paditura ka mbajtur mbledhjen e përgjithshme për aprovimin e pasqyrave financiare të vitit 2016, në të cilën mbledhje edhe ish-in aprovuar pasqyrat financiare. Ka theksuar se baza juridike e kërkesëpadiisë derivon nga dispozitat e Ligjit të Punës dhe Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Në seanca të shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i paditësit ka theksuar se, i kundërshton pretendimet e palës së paditur se kërkesa është e parashkruar, sepse dispozita e nenit 193 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve parashih të drejtën e paditësit që të kërkojë shpërblimin edhe pas afatit të paraparë të parashkrimit. Ka theksuar se, është i gabuar vlerësimi i të paditurës se afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga data e skadimit të marrëdhënies së punës dhe jo nga data kur paditësi i ka lindur e drejta që të kërkojë bonusin, pra nga data kur e paditura i ka aprovuar pasqyrat financiare në prill të vitit 2017. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

E paditura me përgjigje në padi ka theksuar se, palët kanë nënshkruar Kontratën e Punës dhe në Kontratë është paraparë se paditësit do ti paguhej bonusi prej 2.5% në vit, pas miratimit të pasqyrave financiare, ndërsa paditësit pas miratimit të pasqyrave financiare të vitit 2016, e paditura i ka paguar në emër të bonusit për vitin 2015 shumë prej 35,095.06 euro. Ka theksuar se padia e paditësit është paraqitur në Gjykatë para afatit kohorë, ngase paditësi asnjëherë nuk ka paraqitur ankesë tek punëdhënësi lidhur me njoftimin për mos vazhdimin e Kontratës, konform nenin 78 dhe 79 të Ligjit të Punës. Po ashtu ka theksuar se kërkesëpadia e paditësit është e parashkruar ngase nga koha kur marrëdhënia e punës ka përfunduar me datë 30.04.2016 e deri në kohën e paraqitjes së padisë kanë kaluar tre vite e dhjetë muaj, andaj në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës kërkesa e paditësit është e parashkruar, e edhe po qe se si datë e rrjedhjes së afatit të parashkrimit merret data kur paditësi ka paraqitur kërkesë tek e paditura për pagesën e bonusit, edhe një situatë të tillë kërkesa e paditësit është e parashkruar. Tutje ka theksuar se kërkesëpadia e paditësit është edhe e pabazuar, për faktin se Kontrata e Punës ka qenë e lidhur me afat të caktuar 25 Mars 2015 deri 30 Prill 2016, andaj të gjitha të drejtat dhe detyrimet mes të palëve derivojnë gjatë kohëzgjatjes së Kontratës dhe pas skadimit të Kontratës së Punës palët e humbin cilësinë e tyre kontraktuese. Ka shtuar se në Kontratën e Punës është dakorduar në mes të palëve se paditësi ka pasur të drejtën e realizimit të bonusit, pagesa e të cilit varet nga arritja ose tejkalimi i disa kriterëve, dhe se në paragrafin 1 të nenit 7 të Kontratës është përcaktuar pagesa e një bonusi nëse paditësi arrin ta realizojë shumë e caktuar të fitimit neto. Ka shtuar se marrë parasysh se muaji prill i vitit vijues është muaji për aprovimin e pasqyrave financiare, edhe mbledhja e përgjithshme e aksionarëve caktohet dhe mbahet gjatë muajin prill, e meqenëse kohëzgjatja e Kontratës së Punës ka qenë e paraparë të përfundojë me 30 Prill 2016, ndërsa afati për shpërndarjen e bonuseve ka qenë 15 ditë nga aprovimi i pasqyrave financiare, në mënyrë që të krijohet siguri juridike për paditësin, në nenin 7 të Kontratës është specifikuar se bonusi do ti shpërndahet edhe nëse data e shpërndarjes së tij është më e vonshme se data e skadimit të Kontratës së

Punës, dhe këtë obligim e paditura e ka përfunduar me datë 25.04.2016. Ka shtuar se në vitin 2016 nuk ka mundur të ketë pasqyra financiare, e as nuk ka mundur të gjenerohet fitim neto, e as që paditësit nuk i është caktuar asnjë kriter të cilin do të duhej ta arrinte për katër muaj të vitit 2016 në bazë të të cilit do të vlerësohej performanca dhe pastaj të bëhej eventualisht pagesa e ndonjë bonusi shtesë.

Gjykata ka zhvilluar procedurën e të provuarit, dhe me propozimin e palëve ndërgjyqëse ka administruar provat si në vijim: Kontrata e punës e datës 31.03.2015, Pasqyra e pozicionit financiar, datë 31.12.2016, Komunikimet elektronike mes përfaqësuesve të të paditurës dhe paditësit, Dëshmia e pagesës e datës 25.04.2016, Njoftimit për mos vazhdimin e Kontratës, Vendimi i inspektoratit të punës, nr. 01 nr. 12-318-20, i datës 20.01.2021, ekspertiza financiare e datës 23.02.2024.

Pas vlerësimi të të gjitha provave një nga një dhe të gjitha së bashku, konform nenit 8 të LPK-së, gjykata erdhi në përfundimin dhe vlerësimin se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara dhe nga deklarimet e palëve ndërgjyqëse rezulton se në mes të palëve nuk është Kontestuese që paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën në pozitën kryeshefit ekzekutiv të të paditurës, fakt ky i cili vërtetohet edhe sipas Kontratës së Punës së datës 31.05.2015.

Nga Kontrata e punës e datës 31.03.2015, po ashtu vërtetohet se paditësi me të paditurën në Kontratën në fjalë ishin dakorduar që, paditësi për punën e tij të kryer tek e paditura do të kishte të drejtën e një bonusi të performancës. Në nenin 7 të Kontratës së punës palët ishin dakorduar si në vijim: *1. Kryeshefi ekzekutiv ka të drejtën e një bonusi të performancës, pagesa e të cilit varet nga arritja ose tejkalimi i disa kriterëve (gjenerimi i fitimit neto), 2. Pagesa e bonusit të performancës do të bëhet brenda afatit prej 15 ditëve pas mbledhjes së përgjithshme të aksionarëve të Bankës, ku është vendosur për shpërndarjen e fitimit të shpërndarës të vitit të kaluar; 3. Kryeshefi ekzekutiv ka të drejtën e një bonusi të performancës prej 2.5% të totalit të fitimit neto të bankës sipas SNRF-ve, duke përjashtuar rikuperimet nga portofoli i vjetër i kredive të fshira nga bilanci përpara datës 24 Mars 2014. Bonusi i performancës do ti ndahet kryeshefit ekzekutiv pas miratimit të pasqyrave financiare nga Asambleja e Përgjithshme për vitin financiar, edhe pse Kontrata e Kryeshefit Ekzekutiv ka përfunduar në Prill të 2016.*

Nga Komunikimet elektronike mes përfaqësuesve të të paditurës dhe paditësit, vërtetohet fakti se paditësi përmes kërkesës me email kishte kërkuar nga e paditura që ti paguhet shtesa e bonusit të performancës, ndërsa e paditura po ashtu përmes emailit kishte kthyer paditësit përgjigje negative, me arsyetimin se pagesa e një bonusi të tillë nuk ishte paraparë për vitin 2016.

Nga dëshmia e pagesës e datës 25.04.2016, vërtetohet fakti se e paditura i kishte paguar paditësit shumën prej 35,095.06 euro, në emër të bonusit të performancës për vitin 2015 (siç

edhe është përshkrimi i pagesës në flete deponimin në fjalë).

Baza Ligjore

Bazuar në natyrën e kontestit në mes të palëve ndërgjyqëse dhe raportit materialo juridik të krijuar në mes të të njëjtëve, Gjykata vlerëson se gjendja faktike e vërtetuar si më lartë, duhet të kualifikohet nën dispozitat si në vijim.

Me nenin 55 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës në Republikën e Kosovës parashihet: *1. I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit . 2. Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës.*

Me nenin 2 të Ligjit NR. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim referuar si: LMD) parashihet: *1. Pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve janë të lirë, që në pajtim me dispozitat urdhëruese, të rendit publik dhe të dokeve të mira, t'i rregullojnë marrëdhëniet e veta sipas vullnetit të tyre.*

Me nenin 85 të LMD-së, parashihet: *1. Dispozitat e kontratës zbatohen ashtu sikundër e kanë përmbajtjen. 2. Me rastin e interpretimit të dispozitave kontestuese nuk duhet lidhur vetëm për domethënien tekstuale të shprehjeve të përdorura, por duhet hulumtuar qëllimi i përbashkët i kontraktuesve dhe dispozita të kuptohet ashtu sikundër u përgjigjet parimeve të së drejtës së detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj.*

Me nenin 245 të LMD-së, parashihet që: *Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.*

Vlerësimi meritor i Gjykatës

Nga të gjitha provat si më lartë, vërtetimit të gjendjes faktike, dispozitave ligjore, dhe deklaramit të palëve ndërgjyqëse, Gjykata erdhi në përfundimin se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, nga vërtetimi i gjendjes faktike, gjegjësisht nga Kontrata e Punës rezulton se me rastin e nënshkrimit të Kontratës së Punës, paditësi dhe e paditura ishin dakorduar që paditësit për performancën në vendin e punës, ti takonte edhe bonusi prej 2.5% të fitimit neto për vitin paraprak financiar. Fillimisht Gjykata vlerëson se Kontrata e Punës, i nënshtrohet parimit të autonomisë së vullnetit të palëve, sikurse është përcaktuar me nenin 2 të LMD-së, andaj duke u bazuar në një fakt të tillë, nga interpretimi i nenit 7 të Kontratës së Punës, rezulton se në mes të palëve është kontraktuar që paditësi do të realizonte një bonus të performancës, pagesa e të cilit do të varej nga arritja ose tejkalimi i disa kriterëve, gjegjësisht gjenerimi i fitimit neto. Nga vet mënyra se si është formuluar dispozita kontraktuese, vihet në përfundimin se pagesa e bonusit financiar do të

varej nga gjenerimi i fitimit neto, dhe nuk është përcaktuar ndonjë kriter shtesë nga arritja ose mos arritja e të cilit do të varej pagesa ose mos pagesa e bonusit të performancës. Po ashtu në nenin 7 të Kontratës është përcaktuar edhe koha se kur do të bëhej pagesa e këtij bonusi, e që është 15 ditë pas mbledhjes së përgjithshme të aksionarëve të Bankës ku do të vendosej për shpërndarjen e fitimit të shpërndarë të vitit të kaluar. Po ashtu nga interpretimi i nenit 7 të Kontratës së Punës, Gjykatës i rezulton se bonusi do të paguhej për tërë kohën e vlefshmërisë së Kontratës, ngase në nenin 7 të kësaj Kontrate nuk është përcaktuar asnjë kusht dhe/apo kriter kohor për përfitimin e bonusit, por është përcaktuar që *kryeshefi ekzekutiv ka të drejtën e një bonusi të performancës (...)* pa përcaktuar se ky bonus do të i takonte për disa muaj të marrëdhënies së punës, ose vetëm për një kohë të caktuar brenda afatit të vlefshmërisë së Kontratës. Për më tepër, në nenin 7 të Kontratës së Punës po ashtu është përcaktuar se, meqenëse koha kur do të bëhej pagesa e bonusit të performancës, do të ishte pas miratimit të pasqyrave financiare për vitin e kaluar, paditësit do ti paguhej bonusi i performancës pavarësisht faktit nëse Kontrata e Punës kishte skaduar në muajin prill të vitit 2016.

Bazuar në konstatimet si më lartë, sipas vlerësimit të Gjykatës, duke marrë për bazë faktin se sipas interpretimit të Kontratës, paditësit do ti takonte bonusi i performancës për tërë kohëzgjatjen e Kontratës së Punës, e paditura ka pasur për obligim që të njëjtit t'ia paguajë këtë bonus të performancës për tërë periudhën kohore sa ka qenë vlefshmëria e Kontratës së Punës, pra nga data 25 Mars 2015 deri me datë 30 Prill 2016. Nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, është vërtetuar fakti se e paditura i ka paguar bonusin e performancës paditësit vetëm për vitin 2015, në shumën prej 35,095.06 euro, ndërsa fakti se pagesa e këtij bonusi i takonte periudhës së vitit 2015 vërtetohet nga vet fletë deponimi për pagesën e këtij bonusi, ku është dhënë përshkrimi në fletë deponim: *Deponimi i mjeteve të bonusit për 2015*.

Në funksion të kësaj, duke marrë për bazë faktin se pagesa e bonusit paditësit i është bërë për vitin 2015, Gjykata vlerëson se e paditura nuk ka zbatuar në tërësi Kontratën e Punës, pasi që e njëjta nuk i ka paguar paditësit edhe pjesën e bonusit për 4 muajt e parë të vitit 2016, gjegjësisht nga data 01.01.2016 deri me datë 01.04.2016, çka rezulton se për këtë periudhë kontestuese, është krijuar raporti juridik detyrimor në mes të paditësit dhe të paditurës, ku paditësi ka cilësinë e kreditorit dhe paditura cilësinë e debitorit, andaj bazuar në dispozitën e lartë cituar të nenit 245 të LMD-së, paditësi ka të drejtën të kërkoj përmbushjen e obligimit nga e paditura, gjegjësisht shumën e bonusit si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, andaj Gjykata ka vendosur që e paditura të obligohet për përmbushjen e detyrimit në fjalë nga e paditura për paditësin.

Lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë, duke u bazuar në faktin që, sipas Kontratës së Punës ishte përcaktuar që paditësit në emër të bonusit do ti takonte 2.5% e fitimit neto, Gjykata me propozimin e përfaqësuesit të paditësit ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare, me qëllim të llogaritjes fillimisht si cili kishte qenë fitimi neto i të paditurës për periudhën kontestuese 01.01.2016 deri 30.04.2016, dhe pas nxjerrjes së fitimit neto për këtë periudhë, të llogaritet sa është 2.5% e fitimit neto për këtë periudhë kontestuese. Sipas ekspertizës financiare, e punuar nga ekspertja financiare A.S., ka rezultuar se fitimi neto i të paditurës për periudhën kontestuese 01.01.2016 deri 30.04.2016 ishte 1,560,000.00 ndërsa 2.5% i kësaj

shume e cila paditësit do ti takonte në emër të bonusit ishte 35,100.00 euro. Lidhur me llogaritjet e bëra nga ekspertja financiare nuk kanë paraqitur vërejtje as palët ndërgjyqëse, ndërsa Gjykata ekspertizën në fjalë e konsideroj të besueshme ngase e njëjta është hartuar në mënyrë profesionale, se me rastin e llogaritjeve të shumave të fitimit neto ekspertja është bazuar në pasqyrat financiare të të paditurës të deklaruar pranë Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Bazuar në të lartë cekurat, Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësit në emër të kompensimit të bonusit të performancës, për periudhën 01.01.2016 deri me datë 30.04.2016 t'ia paguajë shumën prej 35,100 euro.

Me rastin e vendosjes gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e të paditurës të bëra në përgjigje në padi dhe në seanca gjyqësore, megjithatë të njëjtat ishin pa ndikim në vendosje ndryshe. Kështu, e paditura ka pretenduar se padia e paditësit është e pas afatshme bazuar në nenin 78 dhe 79 të Ligjit të Punës, megjithatë gjykata një pretendim të tillë e vlerëson si të pabazuar, kjo për faktin se kërkesa e paditësit e pretenduar me padi ka të bëjë me kërkesa monetare, gjegjësisht pagesën e bonusit të performancës, ashtu që për kërkesa të tilla monetare që derivojnë nga marrëdhënia e punës nuk zbatohen dispozitat e nenit 78 dhe 79 të Ligjit të Punës, ngase këto dispozita i referohen shkeljeve të të drejtave të punës, që nuk janë të karakterit monetar.

E paditura po ashtu ka pretenduar se kërkesa e paditësit është e parashkruar sipas nenit 87 të Ligjit të Punës, ngase nga dita e përfundimit të marrëdhënies së punës së paditësit (30.04.2016) deri në kohën e paraqitjes së padisë në Gjykatë, datë 25.02.2020, kanë kaluar tre vite e 10 muaj, andaj në një situatë të tillë kërkesa është e parashkruar, megjithatë edhe vlerësimi i tillë për parashkrim të kërkesës për Gjykatën është i pa bazuar. Kjo për faktin se siç është sqaruar më lartë, sipas nenit 7 të Kontratës palët ishin dakorduar që pagesa e bonusit të bëhej pas miratimit të pasqyrave financiare të të paditurës për vitin paraprak financiar. Në këtë kuptim Gjykata sjell në vëmendje nenin 53 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jo bankare, ku në paragrafin 4 të këtij neni parashihet: *Kopja e çdo pasqyre të audituar financiare të bankës, duke përfshirë pasqyrat e konsoliduara financiare, nëse ekzistojnë, i paraqiten BQK-së nga banka kur ato të jenë në dispozicion dhe më së voni brenda katër muajve pas përfundimit të vitit financiar.* Bazuar në këtë dispozitë ligjore, rezulton se pasqyrat financiare të institucioneve bankare, miratohen dhe dorëzohen më së largu katër muaj pas përfundimit të vitit paraprak financiar, e fakti që pasqyrat financiare miratohen tek bankat dhe dorëzohen tek Banka Qendrore e Republikës së Kosovës brenda katër muajve të vitit të ardhshëm për vitin paraprak financiar, është pohuar edhe nga e paditura në përgjigje në padi, duke e pohuar fillimisht faktin se asambleja e aksionarëve për mbajtjen e pasqyra financiare është mbajtur në muajin prill të vitit 2017, dhe se një detyrim i tillë që pasqyrat financiare të miratohen brenda afatit prej katër muajve të parë të vitit, e për vitin paraprak, buron edhe nga Ligji Nr. 04/L-014 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, i datës 26 gusht 2011 (si ligj në fuqi në vitin 2017). Duke u bazuar në këto konstatime, rezulton se paditësi shumën e bonusit për periudhën kontestuese 01.01.2016 deri 30.04.2016 nuk ka pasur mundësi ta kërkojë gjatë vitit 2016, ngase fillimisht nuk do të

dihej se cili ishte gjenerimi i fitimit neto të të paditurës për vitin 2016, pa u miratuar pasqyrat e plota financiare, e për më tepër vet palët kontraktuese në nenin 7 të Kontratës ishin dakorduar që pagesa e bonusit të performancës do të bëhej brenda 15 ditëve pas mbledhjes së përgjithshme të aksionarëve të bankës, ku do të vendosej për shpërndarjen e fitimit të vitit të kaluar. Bazuar në faktin se me Kontratën e Punës ishte përcaktuar që pagesa të bëhej pasi të mbahej mbledhja e aksionarëve dhe të shpërndahej fitimi i vitit të kaluar, rezulton se kërkesa e paditësit është bërë e arritur në fund të muajit prill të vitit 2017, pra pasi që janë miratuar pasqyrat financiare të të paditurës për vitin 2016 (kur edhe është ditur fitimi neto i aprovuar nga asambleja e aksionarëve të të paditurës), e duke u bazuar në një fakt të tillë edhe afati i parashkrimit të kërkesës së paditësit ka filluar të rrjedhë nga fundi i muajit prill i vitit 2017, andaj duke llogaritur nga data 30.04.2017 deri në kohën e paraqitjes së padisë në Gjykatë, pra data 25.02.2020, nuk ka kaluar afati prej tre viteve i paraparë si afat për parashkrimin e kërkesave monetare që derivojnë nga marrëdhënia e punës, sipas nenit 87 të Ligjit të Punës.

Sa i përket kamatës, Gjykata ka vendosur që e paditura shumë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, paditësit t'ia paguajë me kamatë ligjore prej 8% në vit, kjo duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së i cili përcakton: *1. Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*. Lidhur me periudhën se kur fillon të llogaritet kamata, Gjykata ka gjykuar që kamata do të fillojë të llogaritet nga dita kur kërkesa është bërë e arritshme për paditësin, pra data 01.05.2017, kur edhe e paditura ka rënë në vonesë për pagesën e detyrimit ndaj paditësit (lidhur me periudhën e llogaritjes së kamatës lidhur me kërkesat monetare që derivojnë nga marrëdhënia e punës, Gjykata u bazua edhe në mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, me nr.265/2020, i datës 02.12.2020, pika XVII e këtij mendimi juridik).

Gjykata vendosi që e paditura të obligohet për pagimin e shpenzimeve të procedurës, duke u bazuar në nenin 452 të LPK-së, i cili përcakton: *452.1 Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyq fituese, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t'ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore*. Në këtë kuptim, referuar dispozitës ligjore të lartë cituar, Gjykata ka vendosur që të detyrojë të paditurën që, paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës, në shumë prej 1,487.2 euro, dhe atë sipas specifikimit të palës paditëse, 208 euro në emër të përpilimit të padisë, 208 euro në emër të përpilimit të parashtresës për precizim (ngase paditësi nuk ka pasur mundësi për precizimin e lartësisë së kërkesëpadisë pa nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare), për pjesëmarrjen në tre seanca, për secilin nga seancat shumë prej 270,4,00 euro, në emër të taksës gjyqësore shumë prej 60 euro, për ekspertizë financiare shumë prej 200 euro. Gjykata ke refuzuar pjesën tjetër të shpenzimeve, ngase të njëjtat janë kërkuar nga përfaqësuesi i paditësit mbi shumë e përcaktuara sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, e për më tepër Gjykata ka njohur paditësit vetëm shpenzimet e krijuara me qëllim të përfaqësimit të çështjes në Gjykatë. Ndërsa sa i përket shpenzimeve të kërkuara në emër të përkthimit të dokumenteve – provave, një obligim i tillë është obligim ligjor, që provat të paraqiten në gjuhën që është në përdorim zyrtar në Gjykatë, dhe për shpenzimet e tilla nuk mund të ngarkohet pala e paditur.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, bazuar në nenin 160 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.921/2020, datë 20.05.2024

Gjyqtari
Florian Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimet të këtij aktgjykimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.